



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:166683

Datë: 24.09.2024

Numri i dokumentit: 06203982

KPPP.nr. 637/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit K.R.U “Hidrogjeni Jugor” Sh.A., me numër të regjistrimit të biznesit 70433702, kundër debitorit Mert Dekor-Milaim Morina, me seli në Prizren, rr. “Besim Shala”, p.n., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ymer Koro, avokat nga Prizreni, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 413/19, i lejuar me datë 03.04.2019, nga Përmbartuesi Privat Rushit Hoxha me seli në Prizren, jashtë seancës me datë 24.09.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET pjesërisht prapësimi i debitorit Mert Dekor-Milaim Morina nga Prizreni ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr. 413/19, i lejuar me datë 03.04.2019 nga Përmbartuesi Privat Rushit Hoxha për borxhin në shumë prej 1,051.30 EUR, dhe në këtë pjesë të përmbartimit procedura PËRFUNDOHET.
- II. REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit Mert Dekor-Milaim Morina, ashtu që MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr. 413/19, i lejuar me datë 03.04.2019 nga Përmbartuesi Privat Rushit Hoxha, sa i përket borxhit në shumë prej 98.28 EUR.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit K.R.U “Hidrogjeni Jugor” Sh.A., mbi bazën e dokumentit: Kartelë e konsumatorit me shifër KONS-0026397, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 413/19 të datës 03.04.2019, me të cilin është urdhëruar debitori Mert Dekor-

Milaim Morina, që pas pranimit të urdhrin, kreditorit t'ia paguaj shumën prej EUR 1,149.58 (njëmijë e njëqind e dyzet e nëntë euro e pesëdhjetë e tetë cent), si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetim se sipas kartelës së klientit kreditori kërkon borxhin për periudhën prej datës 31.12.2011, deri në muajin shkurt 2019. Ka shtuar se sipas nenit 360, pika 1 të LMD-së parashihet afati një vjeçar i parashkrimit, andaj kërkesa e kreditorit është parashkruar për shkak të kalimit të afatit një vjeçar. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të hedhë si të pasafatshëm, si dhe të detyrohet kreditori që të kompensojë shpenzimet për përpilimin e prapësimin në shumë prej 156.00 EUR.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorit për parashkrim janë të pa bazuara pasi që i njëjti me pagesat që ka realizuar ka ndërprerë parashkrimin. Tutje, ka shtuar se debitori ka paraqitur prapësim mbi katër vite me vonesë pasi që të njëjtit i janë dorëzuar shkresat në adresën ku ka qenë ujëmatësi dhe adresa e debitorit, sepse me lënien në adresë të urdhrin përmbartimor me shkresat e tjera është plotësuar kushti ligjor për dorëzim të shkresave, mirëpo nuk ka paraqitur prapësimin brenda afatit ligjor. Nga të lartcekurat, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke ju referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.2 e të njëjtit nen përcakton ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave si dokumente të besueshme sipas së cilave mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht Kartelën e konsumatorit me shifër KONS-0026397 e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29.3 të LPP-së, meqenëse në ekstrakt janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitorit, janë përshkruar shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Ndërsa, pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit lidhur me afatin e parashkrimit, gjykata ka shqyrtuar ekstraktin mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbarimor në raport me faturat e përfshira ekstrakt dhe në mbështetje të dispozitave nga 355 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (LMD), ka ardhur në përfundim se kërkesa e kreditorit pjesërisht është parashkruar.

Sipas nenit 355.1 të LMD-së, *“1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. Ndërsa me paragrafin 2 të po të njëjtit nen është përcaktuar se: “Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”.*

Në rastin konkret duke llogaritur afatin e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç, rezulton se kërkesat e kreditorit për faturat e përfshira në ekstrakt nga data 31.12.2011 deri me datën 03.04.2016 në shumën prej EUR 1,051.30 kanë arritur afatin e parashkrimit, ngase propozimi për përmbarim nga ana e kreditorit në raport me këto fatura është paraqitur me datë 03.04.2019, ndërsa për secilën nga kërkesat e kreditorit sipas faturave të cekura më lart kanë kaluar më tepër se 3 (tri) vite nga koha e arritjes për pagesë. Mbi këtë bazë, gjykata gjeti se prapësimi i debitorit gjen mbështetje në kuptim të nenit 71, paragrafi 1, pika 1.10 të LPP-së, i cili përcakton se: *“...prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: 1.10. kërkesa nga dokumenti përmbarues është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve”*, andaj gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Ndërsa vendimin mbi përfundimin e procedurës përmbarimore për këtë pjesë të përmbarimit, Gjykata e mbështeti në nenin 66.3 të LPP-së i cili përcakton se *“Përmbarimi do të përfundohet edhe kur ai është bërë i pamundshëm apo kur nga shkaqe të tjera nuk mund të zbatohet, si dhe pas kalimit të afatit absolut të parashkrimit për përmbarim”.*

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke lënë në fuqi urdhrin përmbarimor P.nr. 413/19 të datës 03.04.2019 në shumën prej EUR 98.28 pasi që ky borxh,

derivon nga faturat e lëshuara për periudhën kohore 03.04.2016 e deri me datë 28.02.2019, ndërsa propozimi për përmbardim lidhur me këtë pjesë të borxhit është paraqitur me datë 04.03.2019, brenda periudhës tre (3) vjeçare nga dita kur secila kërkesë është bërë e arritshme.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12.2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbardimore, si dhe nenit 13, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 637/24, datë 24.09.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.